



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA



KATALOGU I PËRFITUESËVE TË BIMËVE MJEKËSORE AROMATIKE



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian



MNE - KOS

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020

Shënim: Ky botim është realizuar me përkrahjen e Bashkimit Evropian përmes IPA II programi i bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë 2014-2020. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Bashkimit Evropian, apo programit IPA II.

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	5
Arber Bicaj.....	6
Argjent Osmanaj.....	7
Dardan Ibrahimimi.....	8
Floriqe Dervishaj.....	9
Januz Binakaj.....	10
Lirim Beqiraj.....	11
Luan Lubeniqi.....	12
Shkelzen Tahiraj.....	13
Violeta Balaj.....	14
Visar Berisha.....	15
Vlora Avdijaj.....	16
Dorentina Gashi.....	17
Elvis Adroviq.....	18
Emerson Zeka.....	19
Emin Sylejmani.....	20
Endrion Nikqi.....	21
Mustaf Gjyheri.....	22
Qelë Shala.....	23
Sokol Bunjoshi.....	24
Veton Shoshi.....	25
Tabela e përfituesve të granteve për kultivim të BMA-ve.....	26

HYRJE

Organizata "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës" (IADK), është duke zbatuar projektin "Krijimi i vendeve të punës në bujqësi" projekt 18 muajsh (2020-2022). Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian përmes programit IPA të bashkëpunimit ndërkufitar në mes Malit të Zi dhe Kosovës. Aktivitetet e projektit në pjesën e Malit të Zi do të zbatohen nga Kryeqyteti Podgorica, kurse në pjesën e Kosovës (Pejë dhe Istog), zbatuese e aktiviteteve të projektit është IADK.

Projekti synon të rrisë dukshmërinë e bujqësisë si sektor i vetëpunësimit, të rrisë kapacitetet e personave të papunë, veçanërisht të rinjve dhe grave rurale për t'u përfshirë në sektorin e bujqësisë, dhe të frymëzojë, motivojë dhe udhëzojë të papunët dhe të rinjtë në veçanti, për të arritur sukses në këtë sektor.


Qëllimi specifik i këtij projekti ka qenë krijimi i vendeve të punës në bujqësi në zonat rurale, ku përmes projektit janë mbështetur gjithësej 20 fermer, prej të cilëve 11 fermer nga komuna e Istogut dhe 9 nga komuna e Pejës, me grante në vlerë mesatare nga 3,700.00 euro, për ngritje të parcelave me bimë mjekësore dhe aromatike, në sipërfaqe nga 2000-2500 m².

Një grup tjetër aktivitetesh i dedikohet promovimit të prodhimit bujqësor vendas dhe atyre akterëve në treg që ofrojnë prodhime vendore si sipërmarrës të përgjegjshëm social. Ky lloj promovimi do të stimulojë një kërkesë në rritje për prodhimet vendore, e cila do të sigurojë hapësirë për prodhuesit e rinj bujqësorë.

Në këtë rast, është e rëndësishme të ndërtohen marrëdhëniet midis pjesëmarrësve të projektit si prodhues bujqësorë dhe blerësve potencialë të produkteve të tyre, dhe të sigurohen lidhjet e shitjes për produktet e tyre. Andaj, në këtë katalog është prezantuar secili përfitues/prodhues i bimëve mjekësore dhe aromatike, në kuadër të projektit, arritjet e tyre, bimët të cilat i kultivojnë dhe që mund t'i ofrojnë në treg. Qëllimi është të përdoret ky botim gjatë takimeve me blerësit e mundshëm, për të ofruar kontaktet e këtyre përfituesve dhe potencialin e tyre për kultivim të bimëve mjekësore aromatike.

Përfituesit e këtij projekti, falë trajnimeve, këshillave direkte dhe mbështetjes me të mira, kanë arritur që përveç përmirësimit të mirëqenjes dhe gjendjes ekonomike të tyre, të arrijnë të prodhojnë bimë të cilësisë së lartë, e gjithashtu të ndikojnë në rritjen e eksportit të këtyre produkteve duke ruajtur ambientin përmes praktikimit të teknikave të kultivimit bio.

Arbër Bicaj, mosha: 24 vjeç
 Vendbanimi: Vrellë, Komuna e Istogut
 Kulturat e kultivuara: Mentë dhe Mëllagë e zezë
 Numri kontaktues: +383 (0) 49 423 654;



Arbër Bicaj së bashku me familjen prej katër (4) anëtarësh jetojnë në fshatin Vrellë, Komuna e Istogut.

Familja e Arbërit dhe ai gjithmonë janë marr me bujqësi; ata kanë kultivuar kultura bujqësore në sasi të vogla dhe i kanë shitur në tregun e fshatit dhe drejtpërdrejt fqinjëve të tyre. Arbëri e ka kaluar pjesën më të madhe të fëmijërisë duke punuar për të fituar ca të ardhura shtesë për familjen e tij.



Arbëri është rritur rreth fermave, dhe duke qenë se bujqësia ishte burimi kryesor i të ardhurave të familjes, ai vendosi të studiojë bujqësinë, në mënyrë që të ndihmonte familjen të prodhonte kultura më cilësore dhe të fitonte më shumë nga sipërfaqet e vogla të kultivuara. Por, njohuritë e tija profesionale nuk ishin të mjaftueshme për të

zgjeruar veprimtarinë e tyre bujqësore; ata kishin nevojë për mbështetje materiale, për të modernizuar mënyrën e kultivimit dhe tharjes së bimëve mjekësore dhe aromatike.

Arbëri përmes projektit të IADK-së për ngritjen e plantacioneve të BMA-ve në komunën e Istogut, u mbështet me fidanë mente dhe mëllagës së zezë, një motokultivator me frezë dhe makinë kositëse, një serrë tharëse prej 80m² dhe sistem të ujitjes për sipërfaqen e mbjellë.

Edhe pse Arbëri kishte një prapavijë profesionale në bujqësi, ai ishte gjithmonë i hapur për të dëgjuar dhe mësuar nga trajnimet dhe këshillat e drejtpërdrejta që i ofroheshin, siç deklaroi "Çka kam mësuar në universitet është shumë më ndryshe në praktikë, prandaj këto këshilla dhe vizitat monitoruese kanë rritur më tej kapacitetet e mia për prodhimin organik duke rezultuar në rendimente më të larta dhe cilësi më të mirë të bimëve".

Arbëri tani planifikon të rrisë sipërfaqen e kultivuar dhe t'u japë mundësinë të rinjve rreth tij që të kenë një vend ku të punojnë, të mësojnë dhe madje të replikojnë atë që bën ai.



Argjent Osmanaj, mosha: 22 vjeç
 Vendbanimi: Trubohoc, Komuna e Istogut
 Kulturat e kultivuara: Kalendulë
 Numri kontaktues: +383(0)44 830 851;
 +383(0)44 365 160;



Argjenti, së bashku me familjen e tij prej gjashtë (6) anëtarësh, jetojnë në fshatin Trubohoc, Komuna e Istogut. Argjenti u rrit duke ndihmuar babanë e tij në bujqësi, pasi bujqësia ishte i vetmi burim që familja e tij të fitoj të ardhura dhe siguroj jetesën. Ata kultivonin specat dhe domate, që vareshin shumë nga kushtet klimatike e gjithashtu rendimenti i tyre nuk ishte asnjëherë i parashikueshëm, gjithashtu tregu i tyre dhe çmimi i tregut nuk ishin të sigurt. Duke u ballafaquar me të gjitha këto shqetësime, Argjenti dhe babai i tij vendosën të fillojnë kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike në një sipërfaqe shumë të vogël, për të cilat kishin tregun e sigurt. Edhe pse sipërfaqja e kultivuar me BMA ishte shumë e vogël, ata ishin në gjendje të gjenerojnë më shumë të ardhura nga kjo sipërfaqe e vogël sesa nga sipërfaqe shumë më të mëdha të mbjellura me kultura të tjera.



Përkundër faktit se të ardhurat e tyre po rriteshin me kultivimin e BMA-ve, ata nuk ishin në gjendje të investonin për të rritur biznesin e tyre. Prandaj, zgjidhja e tyre e vetme ishte të kërkonin mbështetje, të cilën e gjetën në IADK, ku u mbështetën me një serrë tharëse prej 80m², një motokultivator me frezë dhe makinë kositëse, si dhe sistem

ujitjeje për sipërfaqen e mbjellë.

Për një fermer të ri si Argjenti, kjo mbështetje e dhënë, ishte motivim për të vazhduar tutje me bujqësi, të zgjerojë biznesin dhe të kujdeset për familjen e tij, siç theksoi "Të rinjtë kanë frikë nga bujqësia, por për vete, unë jam krenar që jam fermer. Nëse bëhet si duhet, është profesion i mirë që mundëson që dikush të jetë i suksesshëm dhe të plotësojë nevojat e familjes së tij. Personalisht, do të më mundësoj të vazhdoj të kujdesem për prindërit e mi tani dhe të ndihmoj në mirëqenien e familjes".

Dardan Ibrahim, mosha: 30 vjeç
 Vendbanimi: Zallq, Komuna e Istogut
 Kulturat e kultivuara: Mentë dhe Mëllagë të zezë
 Numri kontaktues: +383(0)49 851 490;

Dardan Ibrahimaj, së bashku me familjen e tij prej gjashtë (6) anëtarësh, jetojnë në fshatin Zallq, Komuna e Istogut.

Dardani ishte i interesuar për bujqësinë që në moshë shumë të re. Si fëmijë, ai mësonte nga prindërit dhe i ndihmonte ata në fushë sa më shumë që të mundte. Ata nuk kishin shumë për fillim - një sipërfaqe të vogël toke dhe një numër të vogël të lopëve. Ai ndihmonte që të ushqeheshin lopët dhe kujdesej për to ndërsa prindërit ishin të zënë në fushë. "E dija që një ditë, do të marr përsipër nga prindërit e mi, do të kujdesem për fermën dhe do të vazhdoj traditën", thotë Dardani.

Me kalimin e viteve, familja e tij zgjeroi tokën e kultivuar, por të ardhurat e tyre vareshin shumë nga bujqësia.



Dardani përmes projektit të IADK-së në komunën e Istogut për krijimin e plantacioneve të BMA-ve u mbështet me fidanë mente dhe fidanë të mëllagës së zezë, një motokultivator me frezë dhe makinë kositëse, një serrë tharëse prej 50m2 dhe sistem ujitës për sipërfaqen e mbjellë.

Dardani u mbështet me trajnime dhe këshilla në terren, të cilat e ndihmuan atë të arrijë rezultate të mëdha në fermën e tij.

Dardani, është kujdesur shumë mirë për parcelat e tij, kultivoi bimët sipas këshillave të marra nga eksperti i IADK-së, arriti të shesë pjesën më të madhe të prodhimit të tij dhe të rrisë të ardhurat nga ky aktivitet. "Vetëm me punë të palodhur mund të arrijë rezultate dhe prodhime të tilla", tha Dardani.



Florije Dreshaj, mosha: 50 vjeçare
 Vendbanimi: Vrellë, Komuna e Istogut
 Kulturat e kultivuara: Kalendulë dhe Mëllagë të zezë
 Numri kontaktues: +383(0)45 246 768;



Florije Dreshaj, së bashku me familjen e saj prej gjashtë (6) anëtarësh, jetojnë në fshatin Vrellë, Komuna e Istogut.

Për Florijen, bujqësia, veçanërisht mbledhja e bimëve mjekësore dhe aromatike është burimi kryesor i të ardhurave, pasi që asnjë nga anëtarët e familjes nuk është i punësuar. Sigurimi i të ardhurave vetëm nga ky aktivitet ishte sfidë e madhe për ta. Në mënyrë që Florija dhe familja e saj të gjenerojnë më shumë të ardhura dhe të përmirësojnë gjendjen e tyre financiare, ata filluan vetë të kultivojnë BMA dhe t'i shesin ato të freskëta ose të thara në qendrat e grumbullimit.

"Një dritë në fund të tunelit ishte kjo thirrje e shpallur nga IADK" - tha Florije, kur vendosi të aplikonte për thirrjen me një motivim të madh. Pasi që ekipi i projektit vlerësoi gatishmërinë e saj për t'u angazhuar në një nismë të tillë, ajo u përzgjedh si e përshtatshme për mbështetje dhe mori një motokultivator me frezë dhe kositëse, një serrë tharëse prej 80m² të pajisur me rafte dhe sistem ujitjeje për sipërfaqen e mbjellë me kalendulë dhe mëllagë të zezë.

Për Florijën, trajnimet, këshillat e drejtpërdrejta dhe vizitat monitoruese nga IADK e kanë udhëzuar dhe ndihmuar atë që të ketë sukses në këtë sektor. Kjo është arsyeja pse, ajo po prodhonte cilësi dhe sasi të lartë të BMA-ve, gjë që rezultoi në rritje të të ardhurave për familjen e saj.

Florija tani mbështetë familjen e saj dhe më e rëndësishmja ajo mbështet arsimimin e fëmijëve të saj, gjithashtu nga të ardhurat e fituara ajo do të jetë në gjendje të zgjerojë sipërfaqen e kultivuar për vitin e ardhshëm.



Januz Binakaj, mosha: 41 vjeç

Vendbanimi: Vrellë, Komuna e Istogut

Kulturat e kultivuara: Luledielli dhe Mëllagë e zezë

Numrat kontaktues: +383(0)49311512;
+383(0)45410542;



Januz Binakaj, jeton me familjen e tij prej 6 anëtarësh (gruaja, prindërit dhe dy fëmijët), në fshatin Vrellë, Komuna e Istogut.

Januzi jeton në një fshat të vogël, por me shumë mundësi për zhvillimin bujqësor dhe rural. Ai dhe familja e tij kanë përdorur gjithmonë burimet natyrore të fshatit për të gjeneruar të ardhura, por ata kurrë nuk ishin në gjendje të plotësonin kërkesat e familjes nga këto të ardhura. Në moshë të re,

Januzi vendosi të emigrojë në Mbretërinë e Bashkuar, me shpresën se mund të ndihmonte financiarisht familjen dhe të krijoj kushte më të mira jetese për ta.



Kur u vendos në Mbretërinë e Bashkuar, në fillim, ai mendoi se mund të siguronte jetesën atje, por pas tetë (8) vitesh pune ai kuptoi se jetesa larg familjes nuk i bënte mirë asnjërit prej tyre. Kështu që, ai vendosi të kthehej në shtëpi (në Kosovë) dhe të përdorte disa nga praktikat bujqësore që kishte parë

në Mbretërinë e Bashkuar, dhe të fokusohej në rritjen e fermës familjare në një fermë më të madhe dhe më lehtë të qasshme në treg. Por, për të qenë konkurrues dhe duke synuar të hynte më herët në treg ai kishte nevojë për mbështetje. Prandaj, ai filloi të gjurmojë dhe të kontaktojë organizata të ndryshme bujqësore për ndihmë të mundshme, derisa hasi në thirrjen e shpallur nga IADK, dhe duke i plotësuar të gjitha kriteret ai u përzgjedh si i përshtatshëm për mbështetje.

Z. Binakaj mori trajnim bazë për teknikat e kultivimit të BMA-ve, menaxhimin e fermave dhe për mbajtje të shënimeve në fermë para se të merrte fidanët e BMA-ve për mbjellje, sistemin e ujitjes, serrën tharëse dhe motokultivatorin me frezë dhe kositëse për përgatitjen e tokës dhe heqjen e barojave.

Edhe pse ishte hera e parë që Januzi, kultivoi BMA, ai ishte shumë i suksesshëm, e tëra falë punës së tij të palodhur dhe monitorimit të afërt dhe këshillave të drejtpërdrejta nga IADK.

“Falë grantit me ndihmë materiale, trajnimeve, këshillave të drejtpërdrejta dhe monitorimit të afërt të IADK-së, kam qenë në gjendje të rris kapacitetet e mia prodhuese dhe gjithashtu të ardhurat vjetore të familjes. Me të ardhurat e krijuara nga kjo veprimtari, unë ndihmoj familjen time dhe paguaj për shkollimin e fëmijëve të mi”, tha z. Binakaj.



Lirim Beqiraj, mosha: 26 vjeç
 Vendbanimi: Mojtir, Komuna e Istogut
 Kulturat e kultivuara: Mentë
 Numri kontaktues: +383(0)44 618 284;
 +383(0)49 682 108;



Lirim Beqiraj, së bashku me familjen e tij prej katër (4) anëtarësh, jetojnë në fshatin Mojtir, Komuna e Istogut.

Fshati ku jeton Lirimi është i mbushur me kultivues të BMA-ve për shumë vite tani. Kështu që, Lirimi u rrit rreth fermave të BMA-ve dhe herë pas here punoi si punëtor sezonal në ngastrat e kultivuara në fshatin e tij. Për më tepër, Lirimi ia dha tokën me qira një të afërmi që kultivoi BMA, pasi ai nuk ishte në gjendje t'i kultivonte vetë këto bimë për shkak të kufizimeve financiare dhe mungesës së pajisjeve të nevojshme.



Thirrja e shpallur nga IADK për ngritjen e plantacioneve për kultivimin e BMA-ve, ishte shpresa e vetme që Lirimi të merrej me këtë aktivitet. Me shpresa dhe pritje të mëdha, ai plotësoi aplikacionin dhe dokumentet e kërkuara dhe aplikoi në këtë thirrje. Pasi i kishte plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara për ngritjen e plantacionit të BMA-ve, projekti e

përzgjodhi si përfitues dhe ai mori fidanë mente, një motokultivator me frezë dhe makinën kositëse, një serrë tharëse prej 80m² dhe sistemin e ujitjes për sipërfaqen e mbjellë.

Lirimi ndoqi me shumë entuziazëm të gjithë programin trajnues të IADK-së, si dhe ishte shumë i hapur për të praktikuar këshillat e ofruara përmes sesionit këshillues dhe monitorimeve në fermën e tij. E gjithë asistencë profesionale e pranuar i mundësoi atij që të ketë bimë të cilësisë së lartë dhe rendiment të lartë, duke gjeneruar kështu të ardhura të larta nga ky aktivitet.

“Për shumë vite kam pasur këtë qëllim, të kultivoj tokën time me bimë mjekësore dhe aromatike dhe të bashkëpunoj me fermerët e tjerë në mënyrë që të rritem. Jam vërtet i bekuar që më në fund kam arritur qëllimin tim, të gjitha me ndihmën e madhe të grantit të marrë nga projekti i IADK-së edhe ndihmën profesionale të ofruar nga stafi i IADK-së.” tha Lirimi.



Luan Lubeniqi, mosha: 44 vjeç
 Vendbanimi: Tomoc, Komuna e Istogut
 Kulturat e kultivuara: Mentë dhe Kalendulë
 Numri kontaktues: +383(0)44 932 546;



Luan Lubeniqi, jeton me familjen e tij prej tre (3) anëtarësh, në fshatin Tomoc, Komuna e Istogut.

Pak kohë më parë, jeta e Luanit dukej krejtësisht ndryshe. Burimi i tij i vetëm i të ardhurave ishte nga ferma, e cila është rreth 2 ha. Toka ishte pjellore, por ai nuk përdori teknika të mira mbjelljeje ose farëra të përmirësuara dhe pleh. Si rezultat, ai zakonisht çdo vit kornte sasi të vogla të drithrave, mjaftueshëm për të sjellë ushqim në tryezë për fëmijën e tij, por me pak të ardhura të mbetura. Gjatë periudhave kur kishte prodhim në sasi të vogla, familjes shpesh i mungonin ushqimet dhe duhej të kursenin për t'ia dalë mbanë deri në korrrjen e ardhshme.



Luani kishte përfunduar vetëm vitin e parë të gjimnazit dhe bujqësia ishte i vetmi zanat që njihte. Pasi u përpoq për më shumë se 10 vite për të arritur të korra të mjaftueshme nga toka e tij, Luani mendoi se kishte dështuar. Ai mbante mirëqenien e familjes së tij duke punuar edhe në kompanitë lokale të ndërtimit, por të ardhurat ishin të

pamjaftueshme.

Jeta e Luanit mori një kthesë tjetër pasi mori mbështetjen materiale nga IADK, ku ishte mbështetur me fidanë të BMA-ve, sistemin e ujitjes, një tharëse natyrale 50 m² të pajisur me rafte për tharjen e BMA-ve dhe mekanizmin bujqësor për përgatitjen e tokës dhe largimin e barojave.

Të ardhurat nga bujqësia i janë dyfishuar, madje ai dhe familja e tij tani mund të planifikojnë të zgjerojnë biznesin e tyre bujqësor dhe shpresa u është kthyer.

"Gjithçka këtu filloi nga IADK," thotë Luani për prosperitetin e tij në rritje. "Me përkushtim dhe punë të palodhur, është e mundur të jesh shumë i suksesshëm."



Shkelzen Tahiraj, mosha: 31 vjeç
 Vendbanimi: Kërrninë, Komuna e Istogut
 Kulturat e kultivuara: Hithër dhe Mentë
 Informatat kontaktuese: +383(0)49 647 418;
 +383(0)48 647 418;



Kërrnina, fshat i Istogut, në të cilin gjendet shtëpia e Shkelzenit, ku është rritur dhe jeton me familjen e tij prej 5 anëtarësh. Për shumë nga këta individë në këtë fshat, bujqësia ishte e natyrshme, një jetesë e transmetuar brez pas brezi pa diskutim. Për Shkelzenin, i cili e kuptoi se nuk mund të gjente një punë të qëndrueshme, u bë alternativë e të qenit i papunë.

"Në rininë time isha në një udhëkryq. E lashë shkollën dhe nuk shihja rrugëdalje", tha Shkelzeni. Por prindërit e tij kishin qenë fermerë, kështu që ai vendosi ta provonte. "Kam filluar të merrem me bujqësi dhe sot kam të ardhura të mira."

Shkelzeni, pavarësisht se kultivonte bimë në tokat e tij, është marrë edhe me grumbullimin e bimëve mjekësore dhe aromatike të egra në zonat malore pranë fshatit të tij, ai kishte dashur të fillonte edhe me kultivimin e këtyre bimëve, por njohuritë dhe mundësitë e kufizuara financiare e kishin ndaluar për vite me radhë. Prandaj, ai filloi të gjurmojë dhe të kontaktojë organizata të ndryshme bujqësore për ndihmë të mundshme, derisa hasi në thirrjen e shpallur nga IADK, dhe duke i plotësuar të gjitha kriteret ai u përzgjodh për mbështetje.

Z. Tahiraj mori trajnim bazë për teknikat e kultivimit të BMA-ve, menaxhimin e fermave dhe mbajtjen e librave para se të merrte fidanët e BMA-ve për mbjellje, sistemin e ujitjes, serrën tharëse dhe motokultivatorin me frezë dhe kositëse për përgatitjen e tokës dhe heqjen e barojave.

"Isha i shokuar!" Shkelzeni thotë me një buzëqeshje të madhe, duke kujtuar rezultatet e të korrave të vitit paraprak.

Pasi mësoi si t'i kultivonte vetë BMA-të dhe t'i thajë siç duhet, Shkelzeni i trefishoi të ardhurat nga tokat e tij, e gjitha kjo si rezultat i mbështetjes me të mira dhe vizitave të rregullta monitoruese dhe këshillave që i ofroheshin nga IADK.



Violeta Balaj, mosha: 48 vjeçare
 Vendbanimi: Lluga, Komuna e Istogut
 Kulturat e kultivuara: Mentë
 Informatat kontaktuese: +383(0)44 522 965;
 +383(0)44 281 896;



Violeta Balaj, jeton së bashku me bashkëshortin dhe tre (3) fëmijët, në fshatin Llugë, Komuna e Istogut.

Violeta dhe bashkëshorti i saj prej disa vitesh kultivojnë bimë mjekësore dhe aromatike në një sipërfaqe shumë të vogël; ata gjithashtu kishin mbledhur BMA të egra në zonën e tyre të banimit. Me rritjen e numrit të fermerëve të BMA-ve dhe rrjedhimisht rënien e çmimit të BMA-ve, aktiviteti i tyre bujqësor po bëhej i vështirë për të krijuar varësi.



Violeta u përpoq të gjente një punë diku tjetër, por paga mujore ishte shumë e ulët dhe në interesin e saj më të mirë ishte të zgjeronte biznesin e saj bujqësor, por kjo kërkonte shumë shpenzime për të. Por për fatin e saj të mirë, ajo hasi në thirrjen për mbështetje në kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike të shpallur nga IADK, ku aplikoi dhe u

përzgjodh si përfituese.

Violeta, përmes këtij granti, mundi të zgjerojë sipërfaqen e kultivuar me mentë, dhe ta ujisë këtë sipërfaqe me sistemin e ujitjes pikë-pikë. Për më tepër, ajo tani mund t'i thajë bimët e kultivuara në serrën e saj të tharjes prej 80 m² të pajisur me rafte, si dhe të përgatisë tokën dhe të heqë barojat me motokultivator me frezë dhe kositëse të marrë nga granti mbështetës.

Edhe pse ajo është e angazhuar në këtë aktivitet prej vitesh, më herët nuk ka pasur asistencë profesionale në këtë sektor. Prandaj, trajnimi, këshillat direkte dhe monitorimi i afërt nga IADK, e orientuan Violetën drejt prodhimit me rendiment dhe cilësi më të lartë.

"Ky grant më mundësoi të realizoj idenë time të biznesit. Erdhi në momentin e duhur për mua dhe ka ndikuar jetën time në mënyrë shumë pozitive. Më ka dhënë mundësinë të bëhem një grua sipërmarrëse, të kem punë të qëndrueshme dhe të arrij pavarësinë financiare", tha Violeta.



Visar Berisha, mosha: 37 vjeç

Vendbanimi: Kashicë, Komuna e Istogut

Kulturat e kultivuara: Cian dhe Kalendulë

Informatat kontaktuese: +383(0)44 365 102;
+383(0)44 153 844;

Visar Berisha, baba i dy fëmijëve, tash e sa kohë përballej me vështirësi për të siguruar jetesën e familjes, duke punuar vetëm si punëtor sezonnë në sektorin e ndërtimaterisë.

Babai i Visarit ka pasur bujqësinë si burim shtesë të ardhurash, por për shkak të moshës së vjetër nuk ka qenë në gjendje të vazhdoj dhe të punojë tokën. Prandaj, për vite me radhë toka e tyre ka qenë e paprekur, derisa Visari ka hasur në thirrjen për mbështetje në kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike të shpallur nga IADK, ku aplikoi dhe u përzgjedh për mbështetje.



Visari, përmes këtij granti ka mundur t'i kthehet bujqësisë dhe të kultivojë bimë mjekësore dhe aromatike njëvjeçare, të cilat i ka zgjedhur në koordinim me stafin e IADK-së. Për më tepër, tani ai mund të ujitë këtë sipërfaqe me sistemin e ujitjes me pika, t'i thajë këto bimë në tharësen e tij natyrale prej 80 m² dhe gjithashtu të përgatisë tokën dhe

të heqë barojat me motokultivator me frezë dhe kositës të marrë nga granti mbështetës.

Përkundër faktit se ai nuk kishte asistencë profesionale të mëparshme në këtë sektor, trajnimet, këshillat direkte dhe monitorimi i afërt nga IADK, përmirësuan aftësitë e Visarin lidhje me kultivimin, vjeljen, tharjen dhe shitjen e BMA-ve.

"Përpara mendoja se jeta ime do të ishte e vështirë, por falë IADK-së, tani ndihem i lirë nga ajo jetë," thotë Visari. "Ndihehem shumë i sigurt se jam në gjendje të kujdesem për fëmijët e mi, ndryshe nga më parë. E ardhmja që shoh përpara është e ndritshme tani."



Vlora Avdijaj, mosha: 38 vjeçare
 Vendbanimi: Sinajë, Komuna e Istogut
 Kulturat e kultivuara: Mentë, Mëllagë e zezë dhe Luledielli mjekësor
 Informatat kontaktuese: +383(0)45 300 252; +383(0)44 232 278;



Vlora Avdijaj, së bashku me familjen e saj prej gjashtë (6) anëtarësh jetojnë në fshatin Sinajë, Komuna e Istogut.

Vlora jeton në një fshat ku kushtet për kultivimin e BMA-ve janë shumë të përshtatshme dhe tregu i tyre është i sigurt. Prandaj Vlora dhe bashkëshorti i saj prej disa vitesh kultivonin rigon në një sipërfaqe shumë të vogël. Megjithatë, zgjerimi i kësaj veprimtarie pa asnjë mbështetje ishte një sfidë për ta.

Vlora dhe bashkëshorti i saj kanë kërkuar disa herë mbështetje, por pa përgjigje pozitive, deri sa kanë aplikuar në IADK, në projektin për kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike në komunën e saj. Ekipi i projektit vlerësoi aplikimin e saj, fushat dhe gatishmërinë e saj për t'u angazhuar në një iniciativë të tillë, dhe ajo u përzgjodh si e përshtatshme për mbështetje dhe mori fidane të lulediellit mjekësor, mëllagës së zezë dhe mentës, një motokultivator me frezë dhe makinë kositëse, serrë tharëse 50m2 dhe sistem ujitjeje për sipërfaqen e mbjellë.

Vlora u shpreh shumë e kënaqur edhe me asistencën teknike të marrë nëpërmjet trajnimeve, monitorimeve dhe këshillave direkte dhe falë kësaj mbështetjeje ajo ka arritur të shesë BMA të freskëta dhe të thara, si dhe të përmirësojë të ardhurat e familjes së saj.

“Duke u dashur të rrisja fëmijët dhe të kujdesesha për familjen ishte e vështirë për mua të punoja diku tjetër, ky grant mbështetës më ka bërë të mundur të kem një punë dhe kujdesem për familjen time dhe të arrij pavarësinë financiare”.



Dorentina Gashi, mosha: 22 vjeçare
 Vendbanimi: Buqan, Komuna e Pejës
 Kulturat e kultivuara: Luledielli mjekësor
 Numri kontaktues: +383(0)49 345 105;
 +383(0)45 496 391;



Dorentina Gashi së bashku me familjen e saj prej 12 anëtarësh jetojnë në fshatin Buqan të Komunës së Pejës.

Bujqësia ka qenë traditë familjare për Dorentinën dhe ajo e ka ndihmuar gjithmonë familjen dhe tashmë bashkëshortin e saj me punët në bujqësi.

Familja e saj përbëhet nga 12 anëtarë dhe të ardhurat kryesore të familjes sigurohen nga ky aktivitet. Megjithatë, me rritjen e familjes, të ardhurat e siguruara nga bujqësia po bëheshin të pamjaftueshme. Prandaj, nevoja për mbështetje financiare ose materiale ishte shumë e nevojshme.



Fatmirësisht, Dorentina ka hasur në thirrjen e IADK-së për mbështetje në sektorin e BMA-ve, dhe pas plotësimit të aplikacionit dhe kompletimit të të gjitha dokumenteve të nevojshme, Dorentina është përzgjedhur si e përshtatshme për mbështetje pas vlerësimit në terren dhe teknik nga IADK dhe komuna e Pejës.

Dorentina u mbështet me fidane luledielli mjekësor, serrë tharëse, sistem ujitjeje pikë-pikë dhe motokultivator me frezë dhe kositës. Por më e

rëndësishmja që nga fillimi ajo ka ndjekur trajnimet e organizuara nga IADK, mbi kultivimin e BMA-ve, menaxhimin e biznesit dhe mbajtjen e shenimeve në fermë. Për më tepër, Dorentina ka pasur këshilla direkte që e kanë udhëzuar për mirëmbajtjen e parcelës së lulediellit si dhe për teknikën e tharjes, të cilat kanë rezultuar në rendiment dhe cilësi më të lartë të prodhimit.

"Jam shumë e lumtur pasi përveç faktit që jam fuqizuar nga trajnimet, seancat dhe mentorimi, kam forcuar edhe aftësinë time për të mbështetur familjen time, në një zonë ku përballemi me vështirësi të konsiderueshme, mungesë vëmendjeje dhe investimesh dhe gjithashtu mungesë të infrastrukturës. Jam shumë optimiste për të ardhmen pasi ky grant ka ndikuar pozitivisht tek unë dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e aktivitetit tim bujqësor.

"Faleminderit për këtë mundësi, pasi ndihma juaj është jashtëzakonisht e rëndësishme se më dha motivim shtesë për të ardhmen. Shpresoj që veprimtaria ime të rritet më tej me potencialin për të punësuar punëtorë shtesë dhe, në këtë mënyrë, të kontribuoj në zhvillimin ekonomik të fshatit tim."



Elvis Adroviq, mosha: 27 vjeç

Vendbanimi: Vitomiricë, Komuna e Pejës

Kulturat e kultivuara: Kalendulë dhe Mëllagë e zezë

Numri kontaktues: +383(0)49 522 813;



Elvis Adroviq, jeton me familjen e tij prej pesë (5) anëtarësh, në fshatin Vitomiricë të Komunës së Pejës.

Si minoritet e kishte të vështirë të gjente punë të përshtatshme dhe të kishte rol në shoqëri, prandaj filloi të punonte në një kompani lokale të BMA-ve si punëtor sezonal, ku mësoi për të gjithë procesin nga kultivimi deri te shitja e tyre.

Puna në një kompani të BMA-ve i dha Elvisit idenë që t'i kultivonte vetë këto bimë, por e kishte të pamundur të merrej me këtë aktivitet për shkak të kufizimeve financiare. Por falë projektit të IADK-së ëndrra e tij u bë realitet dhe filloi të kultivonte kalendulën dhe t'ia shiste kompanisë ku kishte punuar si punëtor sezonal.

Z. Adroviq mori trajnim bazë për teknikat e kultivimit të BMA-ve, menaxhimin e fermave dhe kontabilitet para se të merrte fidanët e BMA-ve për mbjellje, sistemin e ujitjes, serrën tharëse dhe motokultivatorin me frezë dhe kositëse për përgatitjen e tokës dhe heqjen e barojave.

“Kjo punë ka sfidat e veta, por jam shumë i kënaqur dhe mirënjohës për mbështetjen që kam marrë, e cila ka rëndësi të madhe sidomos për të rinjtë si unë. Mendoj se ky projekt ka qenë veçanërisht motivues për ne që jetojmë në zonat rurale dhe nuk kemi shumë mundësi për t'u zhvilluar, kështu që shpresoj të jetë një shembull i mirë për të rinjtë e tjerë në rajonin ku jetoj”, tha Elvisi.



Emerson Zeka, mosha: 24 vjeç
 Vendbanimi: Komuna e Pejës
 Kulturat e kultivuara: Kalendulë
 Numri kontaktues: +383(0)49 336 110;

Emerson Zeka, jeton me familjen e tij prej katër anëtarësh në Komunën e Pejës.

Emersoni së bashku me të vëllanë prej disa vitesh janë marrë me kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike dhe kanë mbetur shumë të kënaqur me të ardhurat e realizuara nga ky aktivitet. Megjithatë, zgjerimi i këtij aktiviteti kërkonte shpenzime financiare dhe pajisje shtesë dhe më e rëndësishmja një serrë tharjeje, në mënyrë që ata të shisin produktet e tyre me çmim më të lartë si të thara. Emersoni dhe vëllai i tij, të dy aplikuan në thirrjen e shpallur nga IADK për grantin mbështetës, në mënyrë që të rrisin shanset e tyre për t'u mbështetur. Pas pranimit të aplikacionit të tyre, Emersoni u përzgjedh për mbështetje.

Emersoni mori trajnim bazë për teknikat e kultivimit të BMA-ve, menaxhimin e fermave dhe mbajtjen e shenimeve para se të merrte sistemin e ujitjes, serrën tharëse dhe motokultivatorin me frezë dhe kositëse për përgatitjen e tokës dhe heqjen e barojave.

Pakoja e grantit ka ndihmuar Emersonin të zgjerojë sipërfaqet e kultivuara me BMA-të njëvjeçare, dhe bashkë me të edhe të ardhurat e tyre. "Çfarëdo që kam bërë - është e gjitha sepse mu dha shansi pavarësisht mungesës së përvojës. IADK pati besim tek unë dhe më fuqizoi të arrij sukses. Dhe unë jam përgjithmonë mirënjohës për këtë mundësi, e cila më mundësoi të rris aktivitetin bujqësor dhe të gjeneroj të ardhura për të investuar edhe vetë në zgjerimin e veprimtarisë sime."



Emin Sylejmani, mosha: 61 vjeçar
 Vendbanimi: Leshan, Komuna e Pejës
 Kulturat e kultivuara: Hithër dhe Kalendulë
 Numri kontaktues: +383(0)44 994 636;



Emin Sylejmani është një fermer i vogël i përkushtuar, që jeton në një fshat të vogël dhe shumë të përshtatshëm për zhvillimin e bujqësisë.

Emini ka qenë rreth fermave që kur ishte fëmijë, ai u rrit, duke parë familjen e tij që kultivon ushqimet e veta dhe i shitnin të freskëta në treg. Ai ndoqi rrugën e babait të tij, dhe rriti edhe fëmijët e tij me fruta dhe perime të shëndetshme, të freskëta të prodhuara në shtëpi.



Me rritjen e numrit të fermerëve në fshatin e tij, Emini e kishte të pamundur të vazhdonte dhe të varej nga të ardhurat nga bujqësia pa pasur pajisjet dhe mbështetjen e nevojshme. Ndërsa shpresat e tij po zbeheshin, ai hasi në thirrjen e shpallur nga IADK dhe aplikoi për grantin mbështetës për kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike. Ekipi i projektit

vlerësoi aplikimin e tij, fushat dhe gatishmërinë e tij për t'u angazhuar në një iniciativë të tillë, dhe ai u përzgjodh si i përshtatshëm për mbështetje dhe mori fidanë të kalendulës dhe hithrit, një motokultivator me frezë dhe makinë kositëse, një serrë për tharje prej 80 m² dhe sistem ujitjeje.

Emini gjithashtu u shpreh shumë i kënaqur me ndihmën teknike të marrë, siç theksoi: "Unë mendoja se në këtë moshë askush nuk mund të më mësonte asgjë për bujqësinë, por u tregua se kisha gabuar sepse kam mësuar shumë gjëra që nuk i dija nga trajnimet, këshillat e drejtpërdrejta dhe vizitat monitoruese, në fakt më duket sikur nuk dija asgjë".

Emini është kujdesur shumë mirë për parcelat e tij dhe ka arritur t'i shesë produktet e tij në qendrën e grumbullimit në rajonin e tij, dhe të përmirësojë të ardhurat, gjë që e bindi të rrisë parcelat e tij dhe të fokusohet plotësisht në kultivimin dhe shitjen e BMA-ve.



Endrion Nikqi, mosha: 21 vjeç
 Vendbanimi: Nabergjan, Komuna e Pejës
 Kulturat e kultivuara: Kalendulë, Cian dhe
 Mëllagë e zezë
 Numri kontaktues: +383(0)43 568 443;



Endrioni jeton me familjen prej 4 anëtarësh, në një shtëpi të vogël në fshatin Nabergjan të Komunës së Pejës.

Si fermer i ri, Endrioni është përballur gjithmonë me vështirësi për të siguruar të ardhura të mjaftueshme dhe për të blerë pajisjet thelbësore për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Për të gjeneruar më shumë të ardhura për familjen e tij ai punon si punëtor sezonal në ferma të tjera të BMA-ve në fshatin e tij.



Endrioni si shumë fermerë të tjerë ka kërkuar disa herë mbështetje por pa sukses, dhe gjersa kishte ndjenjën e gatishmërisë për të hequr dorë nga bujqësia pasi që punët po bëheshin të padurueshme pa mbështetjen e nevojshme, ai hasi në thirrjen e IADK-së, ku vendosi të aplikonte për herë të fundit.

Ekipi i projektit vlerësoi aplikimin e tij, fushat dhe gatishmërinë e tij për t'u angazhuar në një iniciativë të tillë, dhe ai u përzgjodh si i përshtatshëm për mbështetje dhe mori fidanë të kalendulës, cianit dhe mëllagës së zezë, një motokultivator me frezë dhe makinën kositëse, një serrë tharëse prej 80 m² dhe sistem ujitjeje.

Endrioni ishte gjithashtu shumë i kënaqur me asistencën teknike të marrë përmes trajnimeve, monitorimit dhe shërbimeve të drejtpërdrejta këshilluese dhe falë kësaj lloj mbështetjeje ai ka arritur të shesë BMA të freskëta dhe të thara, si dhe të dyfishojë të ardhurat e tij vjetore.

“Me këtë biznes mbaj familjen time dhe duhet të pranoj se ky projekt ka qenë shumë i përshtatshëm dhe i dobishëm për ne”, tha Endrioni.



Mustaf Gjyheri, mosha: 50 vjeç

Vendbanimi: Ruhot, Komuna e Pejës

Kulturat e kultivuara: Kalendulë, Cian dhe Mëllagë e zezë

Numri kontaktues: +383(0)49 820 727;

Mustaf Gjyheri, jeton me familjen e tij prej katër anëtarësh (gruan dhe dy fëmijët) në fshatin Ruhot të Komunës së Pejës.

Z. Gjyheri, si minoritet e kishte të vështirë të gjente punë të përshtatshme dhe të kishte rol në shoqëri, prandaj vendosi të merrej plotësisht me bujqësi, edhe pse në fillim e kishte të vështirë pa pasur asnjë mekanizëm bujqësor.

Z. Gjyheri dëgjoi nga fermerët e lagjes se IADK ka bërë thirrje për mbështetje në kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike, menjëherë ka aplikuar dhe pas vlerësimit është përzgjedhur për mbështetje.



Z. Gjyheri mori trajnim bazë për teknikat e kultivimit të BMA-ve, menaxhimin e fermës dhe mbajtjen e shenimeve në fermë para se të merrte fidanët e BMA-ve për mbjellje, sistemin e ujitjes, serrën tharëse dhe motokultivatorin me frezë dhe kositëse për përgatitjen e tokës dhe heqjen e barojave.

Kjo paketë e grantit së bashku me seancat e drejtpërdrejta këshilluese dhe monitorimi i mundësoi z. Gjyheri të ketë rendimente dhe të ardhura të larta, si dhe të angazhojë gruan e tij që nuk kishte punuar më parë. Për më tepër, nga të ardhurat e krijuara nga kultivimi i BMA-ve, Z. Gjyheri ka mundur të paguajë tarifën e shkollimit për djalin e tij, i cili në pamundësi të paguante tarifën e shkollimit, kishte një vit që priste të merrte diplomën.

“Falë këtij angazhimi dhe mbështetjes së IADK-së, unë dhe familja ime jo vetëm që mund të prodhojmë bimë mjekësore por edhe mbajmë veten ekonomikisht. Granti mbështetës, trajnimet, këshillat dhe monitorimi i afërt na kanë ndihmuar të përmirësojmë standardin e jetesës dhe të kemi të ardhura më të larta. Tani, puna në fushat e mia dhe mbështetja për familjen më motivon të përpiqem edhe më shumë, të zgjeroj njohuritë dhe aktivitetet e mia bujqësore edhe më shumë. Jemi të lumtur që mund të punojmë në veprimtarinë tonë të vogël familjare, duke krijuar kështu një të ardhme më të sigurt dhe më të ndritshme”, ishin fjalët e z. Gjyheri kur u pyet për përvojën e tij me projektin.



Qelë Shala, mosha: 63 vjeç
 Vendbanimi: Loxhë, Komuna e Pejës
 Kulturat e kultivuara: Hithër
 Numri kontaktues: +383(0)44 402 710;



Qelë Shala është një fermer i vogël, që jeton në një fshat të vogël dhe shumë të përshtatshëm për zhvillimin e bujqësisë, së bashku me familjen e tij prej tre (3) anëtarësh.

Për Qelën, bujqësia është aktiviteti më i përshtatshëm për të gjeneruar të ardhura, pasi që nga mosha e hershme ka qenë rreth fermave dhe deri më sot gjithmonë praktikoi bujqësinë. Z.Shala gjatë jetës së tij ka kultivuar kultura të ndryshme, por ishte shumë i vullnetshëm që të fillonte me kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike. Mirëpo, hyrja në këtë aktivitet të ri kërkonte kapacitete financiare dhe profesionale, të cilat i



mungonin.

Si i tillë, z. Shala ishte shumë i motivuar për të kërkuar çdo mundësi tjetër derisa sa ra në kontakt me IADK-në. Ku është ndihmuar në plotësimin e dokumenteve të kërkuara dhe ka aplikuar për grantin mbështetës. Ekipi i projektit vlerësoi aplikimin e tij, fushat dhe gatishmërinë e tij për t'u

angazhuar në një iniciativë të tillë, ai u përzgjedh si i përshtatshëm për mbështetje dhe mori fidanë hithri, një motokultivator me frezë dhe makinë kositëse, një serrë tharëse 50m² dhe sistem ujitjeje.

Për z. Shala ndihma profesionale si trajnimet, seancat e drejtpërdrejta këshilluese dhe vizitat monitoruese ishin të një rëndësie të madhe, të cilat e orientuan drejt prodhimit të hithrit me cilësi të lartë edhe pse ishte hera e parë që merrej me prodhimtarinë organike dhe siç tha ai "Unë vetë isha shumë i befasuar me suksesin që kam pasur dhe të ardhurat që kam realizuar nga ky aktivitet, ndaj po mendoj të fokusohem plotësisht në kultivimin e BMA-ve".



Sokol Bunjoshi, mosha: 31 vjeç
 Vendbanimi: Komuna e Pejës
 Kulturat e kultivuara: Hithër
 Numri kontaktues: +383(0)49 710 023;



Në tokat pjellore të komunës së Pejës jeton një fermer i vogël, Sokol Bunjoshi, së bashku me familjen e tij prej 6 anëtarësh.

Sokoli është një fermer i ri entuziast që pa potencialin e madh për gjenerimin e të ardhurave nga bujqësia. Fillimisht, ai filloi rrugëtimin e tij për të investuar në një fermë pulash; duke punuar në fermën e tij ai ishte në gjendje të mbulonte disa nga nevojat financiare të familjes. Duke qenë i interesuar për t'u angazhuar më tej në sektorin e bujqësisë, Sokoli u njoh me mundësitë që janë të pranishme në kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike ai ishte i etur për të mësuar më shumë dhe për t'u angazhuar në këtë sektor.

Duke qenë shumë i interesuar për këtë sektor dhe në kërkim të vazhdueshëm për ndihmë financiare dhe profesionale, një mik i Sokolit ia prezantoi IADK-në. Sokoli shfrytëzoi rastin për të kuptuar më shumë se çfarë mund të ofrojë IADK përmes projektit të saj dhe kështu vendosi të aplikojë për grant. Përpjekjet e Sokolit nuk shkuan huq, pasi komisioni vlerësues pasi analizoi me kujdes aplikimin e tij dhe bëri vizitën në terren, vendosi ta mbështeste me fidanë hithre, sistem ujitjeje për sipërfaqen e mbjellë, tharëse natyrale dhe motokultivator me frezë dhe kositëse.

Sokoli ishte shumë entuziast dhe shumë i motivuar për të marrë ndihmën profesionale e shumë kërkuar përmes trajnimeve. Kur eksperti i IADK-së filloi të zhvillojnë këshillat direkte dhe vizitat monitoruese, familja e tij dhe Sokoli ishin të kënaqur të kuptonin më tej se si mund të prodhonin hithër të cilësisë së lartë. Në fund të vizitave, Sokoli donte të shprehte përshtypjet e tij për projektin ku tha dhe citojmë “në fillim mendimi për kultivimin dhe shitjen e hithrës ishte emocionues dhe i frikshëm, por me ndihmën e grantit dhe ndihmën e vazhdueshme të ofruar nga IADK, ky proces u bë më i lehtë dhe më pas i kuptueshëm. Angazhimi në këtë sektor ka rezultuar shumë i dobishëm për mua dhe familjen time, dhe për këtë dua të falënderoj sinqerisht donatorin dhe IADK-në”.



Veton Shoshi, mosha: 30 vjeç
 Vendbanimi: Komuna e Pejës
 Kulturat e kultivuara: Mentë
 Numri kontaktues: +383(0)49 895 952;



Vetoni jeton vetëm me nënën e tij dhe në moshë të re u bë përgjegjës për sigurimin e të ardhurave për familjen dhe mirëqenien e familjes.

Puna në sektorin privat dhe pa të ardhura të qëndrueshme, për Vetonin po bëhej e vështirë, prandaj vendosi që të ardhurat e veta t'i siguronte nga bujqësia ku kishte shumë vite që punonte si punëtor sezonal. Së bashku me shokun e tij vendosën që të marrin me qira pak tokë dhe të kultivojnë bimë mjekësore dhe aromatike të cilat kanë treg të sigurt në rajonin e tyre. Megjithatë, përfshirja në një aktivitet të tillë kërkonte disa inpute të cilat ai nuk i kishte.



Si i tillë, z. Shoshi ishte shumë i motivuar për të kërkuar çdo mundësi tjetër derisa sa ra në kontakt me IADK-në, ku është asistuar në plotësimin e dokumenteve të kërkuara dhe ka aplikuar për grantin mbështetës. Ekipi i projektit vlerësoi aplikimin e tij, fushat dhe gatishmërinë e tij për t'u angazhuar në një iniciativë të tillë, ai u përzgjodh si i

përshtatshëm për mbështetje dhe mori fidane mente, një motokultivator me frezë dhe kositëse, një serrë tharëse 50m² dhe sistem ujitjeje.

Për z. Shoshi ndihma profesionale si trajnimet, seancat e drejtpërdrejta këshillimore dhe vizitat monitoruese ishin të një rëndësie të madhe, të cilat e orientuan drejt prodhimit të mentës me cilësi të lartë edhe pse ishte hera e parë që merrej me prodhimtarinë bujqësore dhe siç tha ai "Që kur kam filluar me kultivimin e BMA-ve, unë jam në gjendje të plotësoj disa nga nevojat e familjes që po përpiquesha t'i plotësoja. Në fillim isha skeptik që disa pajisje dhe disa këshilla mund të përmirësonin rendimentet e mia dhe të më ndihmonin të krijoja të ardhura."



Të dhënat e prodhuesve të BMA-ve, sipërfaqet e kultivuara me lloje të ndryshme (m ²) gjatë vitit 2021											
Nr.	Emri dhe mbiemri	Komuna	Vendbanimi	Telefoni	Mentë	Hithri	Kalendul ë	Cian	Mullagë e zezë	Luledielli	Total sip. m ²
1	Arber Bicaj	Istog	Vrellë	049-423-654	1500				500		2000
2	Argjend Osmanaj	Istog	Trubohoc	044-830-851			2500				2500
3	Dardan Ibrahim	Istog	Zallq	049-815-490	2000				500		2500
4	Flori Dreshaj	Istog	Vrellë	045-246-768			2000		500		2500
5	Januz Binakaj	Istog	Sudenicë	049-311-512					500	2000	2500
6	Lirim Beqiraj	Istog	Mojstir	049-682-108	2000						2000
7	Luan Lebeniqi	Istog	Tomoc	044-932-546	1500		500				2000
8	Shkelzen Tahiraj	Istog	Kerrinë	049-647-418	500	2000					2500
9	Violeta Balaj	Istog	Lluga	044-522-965	2000						2000
10	Visar Berisha	Istog	Kashicë	044-365-102			1000	1000			2000
11	Vlora Avdijaj	Istog	Sinaje	045-300-252	1500				500	500	2500
12	Dorentina Gashi	Pejë	Buqan	045-496-391						2500	2500
13	Elvis Adrovic	Pejë	Vitomirice	049-522-813			2000		500		2500
14	Emerson Zeka	Pejë	Pejë	049-336-110			2500				2500
15	Emin Sylejmani	Pejë	Lesham	044-994-636		1500	500				2000
16	Endrion Nikqi	Pejë	Nabergjan	043-568-443			1000	1000	500		2500
17	Mustaf Gjyheri	Pejë	Ruhot	049-820-727			1000	1000	500		2500
18	Qelë Shala	Pejë	Loxhë	044-402-710		2500					2500
19	Sokol Bunjoski	Pejë	Pejë	049-710-023		2500					2500
20	Veton Shoshi	Pejë	Pejë	049-895-952	2500						2500
Gjithësejt sipërfaqe të mbjella me BMA (m ²)					13500	8500	13000	3000	4000	5000	47000



Adresa:
Sfaraçak
i Ulët, Nr.11,
42.000 Vushtrri,
Kosovë

Te jetojmë nga toka dhe puna jonë

www.iadk.org
info@iadk.org
facebook.com/iadk.org
+383 49 777 046
+393 44 777 036